**VENDIM**
**Nr. 25, datë 22.2.2013**

**MBI SHTYRJEN E ANKANDIT VJETOR TË KAPACITETEVE TË INTERKONJEKSIONIT PËR VITIN 2013**

Në mbështetje të nenit 8 pika 2 germa "ç" paragrafi "ii" dhe 9 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, pikës 7 germa "b" të "Modelit të tregut të energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 338, datë 19.3.2008, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e tij të datës 22.2.2013, pasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut

VENDOSI:

1. OST sh.a. të shtyjë zhvillimin e ankandit vjetor për kapacitetet ndërkufitare të interkonjeksionit për vitin 2013, në drejtim importi, deri në datën 30.6.2013.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Sokol Ramadani**